

**URDHËR
PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

Drejtuar: **Qendrës Kombëtare të Regjistrimit**, me adresë në:
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë;

Për dijëni Debitorit: Shoqëria **"BIG LIQENI"** Sh.p.k., me NIPT
L44213602I, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga "10
Dëshmorët e Pojskës", Pallati i ri "FIDAI", Kati 1,
Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet
Brahollari**;

Për dijëni Kreditorit: **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe
Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, me adresë:
Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr. 80, Hyrja nr. 1, Kati 5,
Tiranë, Shqipëri; Komisioneri **Z. Besnik Dervishi**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë **shoqërisë përmbartimore gjyqësore
private "ARB" Sh.p.k.**, ("ARB") pasi studiova materialet e dosjes përmbartimore Nr. **399**,
bazuar në Vendimin Administrativ Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për Mbrojtjen e
të Dhënave Personale,

KONSTATOVA:

Se më datë 14.07.2016 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit Komisioneri për të
Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, së bashku me:

1. Vendimin Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe
Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili vendosi:

- Dënimin e kontrolluesit "Big Market" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë)
lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për
Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

- Dënimin e kontrolluesit "Big Market" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë)
lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për
Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

- Gjoba arkëtohet nga kundravajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë)
ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati ky vendim kthehet në titull
ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së
Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

- Ky vendim u shpall sot në, 09.05.2016.

Pas marrjes dijëni të debitorëve, si dhe kalimit të afatit 10 (dhjetë) ditor të Lajmërimit
për Ekzekutim Vullnetar, datë 25.07.2016, për ekzekutimin e Vendimin Administrativ të
sipërpërmendur, duhet të kryhen bllokimet e menjëhershme të aksioneve/kuotave apo
interesave të tjera të **debitorit**:

- Shoqëria **"BIG LIQENI"** Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1,
Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës", Pallati i ri "FIDAI", Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues
Ligjor **Z. Valdet Brahollari**.






Për sa më sipër, në zbatim të neneve **527**, e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit Nr. **10 031**, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Privat”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”

URDHËROJ:

1. Vendosjen e menjëhershme të masës së sekuestros konservative në kuotat e shoqërisë “**BIG LIQENI**” Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga “10 Dëshmorët e Pojskës”, Pallati i ri “FIDAI”, Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet Brahillari**; dhe moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar; dhe
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore Shoqëria “**BIG LIQENI**” Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga “10 Dëshmorët e Pojskës”, Pallati i ri “FIDAI”, Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet Brahillari**; në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. *Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.*
5. Ky Urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve.

Shoqëria “ARB” Sh.p.k.
Përmbartuesi Gjyqësor Privat
Alban Ruli



Bashkangjitur do të gjeni:

- Titulli Ekzekutiv - Vendimin Administrativ Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe
- Shkresa Nr. **8352/1** Prot., datë **11.06.2016** “Informacion” të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; dhe
- Shkresa Nr. **1/399** Prot., datë **25.07.2016**, e **ARB**, “Lajmërim për Ekzekutim Vullnetar”; dhe
- Lajmërim Marrje ku debitori ka marrë dijani.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 442/3 Prot

Tiranë, më 9/5/2016

V E N D I M

Nr. 17 ,datë 9/5/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, "**Big Market**" Pogradec.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 99 ,datë 12.04.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "**Big Market**" Pogradec (Nipt L44213602I), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi ushtron aktivitetin në fushën e tregtimit të artikuljeve të ndryshëm me shumicë e pakicë dhe gjatë veprimtarisë mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për kategorinë e subjekteve punëmarrës dhe klientë. Për kategorinë punëmarrës përpunon të dhënat personale të identifikimit, të dhënat e librezës së punës, të kartës së identitetit, CV, diplomë dhe të dhënën sensitive gjendja penale. Për kategorinë klientë përpunon të dhënat personale emër dhe nr. telefoni. Kontrolluesi përpunon të dhënat e punëmarrësve me qëllim menaxhim të burimeve njerëzore si dhe në zbatim të detyrimeve ligjore (Kodi i Punës) ndërsa të dhënat e klientëve përpunohen me qëllim pajisjen me kartën e klientit.

Gjithashtu, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave, nëpërmjet mbikëqyrjes së ambienteve me kamera vëzhgim regjistrimi CCTV.

I. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "**Big Market**" Pogradec, kishte vendosur në ambientet e brendshme dhe të jashtme 16 kamera vëzhgim regjistrimi CCTV. Nëpërmjet sistemit të video-survejmimit mblidhen dhe përpunohen të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave (punëmarrës dhe klientë).



Në lidhje me këtë përpunim u konstatua se kontrolluesi nuk realizon informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejimit në hyrje të ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.

2. Nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushruar rezultoi se nga kontrolluesi "Big Market" Pogradec nuk ishte përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Megjithatë, konstatohet se kontrolluesi ka reaguar duke plotësuar menjëherë detyrimin për të njoftuar (neni 21).

3. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Big Market" Pogradec nuk kishte hartuar një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj. në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datë 05/05/2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, në të cilën përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti pretendimet me shkrim (administruar në dosjen hetimore në cilësinë e provës) lidhur me marrjen e masave për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Në tërësi kontrolluesi nuk i ka kundërshtuar konstatimet e Komisionerit dhe ka deklaruar se, *mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së ligjit si dhe ka marrë masat duke plotësuar*



detyrimin për njoftim, informimin duke vendosur tabelën e tipit standart në ambientet e marketit, ku informon që ambienti monitorohet nga kamerat, për klientët besnik të marketit aia njoftohen paraprakisht dhe ju merret pëlqimi për këto të dhëna duke plotësuar formularin e kartës së klientit. Gjithashtu janë marrë masat e nevojshme për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në lidhje me pretendimin se, nuk ka pasur dijeni për ligjin, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk përbën shkak për mospërbushje të detyrimeve ligjore dhe përjashtimin nga përgjegjësia.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat "b" dhe "dh" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- Kontrolluesit ose përpunuesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 150 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar mbi përpunimin e të dhënave dhe masat e sigurisë në zbatim të ligjit. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:


Në zbatim të neneve 18, 27, 30, 31, 39/1/b, 39/1/d dhe 39/1/dh, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenit 72/3 të Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":


V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "**Big Market**" Pogradec me gjobë, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "**Big Market**" Pogradec me gjobë, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 9.7 2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI





KD.M.D.H.P.
Nr. 7271 Prot.
Datë 13.7.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Adresa: Rruga "Ibrahim Pashe Bushatliu" Nr. 1001 Tirane Shqiperi Tel +355 (0) 42 44 70 88

Nr. 832/A Prot.

Datë 11/06/2016

Lenda: Dergim Vendimi gjyqesor, Informacion

Drejtuar: Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dheneve Perosnale

Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 727 prot, date 29.06.2016 po ju percjellim vendimin gjyqesor, nr.2782, date 2.06.2016 me pale:

Padites: Spitali IKEDA EUROMEDICA shpk

I paditur: Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dheneve Perosnale

Objekt: Konstatim pavlefshmerie absolute e vendimit nr. 04, date 10.03.2016.

Ne vijim, ju informojme se subjektet e meposhtme nuk kane kundershtuar vendimet e Komisionerit per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dheneve Personale.

1. Subjekti Supermarket Big Market Pogradec
2. Spitali Universitar Shefqet Ndroqi
3. Spitali Rajonal Elbasan
4. Spitali Universitar I Traumes

Subjekti **Spitali Rajonal Durres** ka paraqitur kerkese padi me date 21.06.2016 me **objekt:** Anullimin e vendimit nr 21 date 13.05.2016 te Komisionerit per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale" duke anuluar denimin per gjoben e vene ne vleren 300.000 leke ndaj Spitalit Rajonal Durres.

.Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

KANCELAR
ARBER KUSHE

REPUBLICA
DE GUATEMALA
SERVICIO DE
REGISTRO Y
CATASTRO

**LAJMËRIM
PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**

Drejtuar Debitorit: Shoqëria "**BIG LIQENI**" Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës, Pallati i ri "FIDAI", Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet Brahillari**;

Për dijeni Kreditorit: **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr. 80, Hyrja nr. 1, Kati 5, Tiranë, Shqipëri; Komisioneri **Z. Besnik Dervishi**.

Unë, **Alban Ruli**, përbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përbarimore gjyqësore private "**ARB**" Sh.p.k., ("**ARB**") pasi studiova materialet e dosjes përbarimore Nr. **399**, bazuar në Vendimin Administrativ Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KONSTATOVA:

Se më datë 14.07.2016 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, së bashku me:

1. Vendimin Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili vendosi:

- Dënimin e kontrolluesit "**Big Market**" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

- Dënimin e kontrolluesit "**Big Market**" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

- Gjoha arkëtohet nga kundravajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

- Ky vendim u shpall sot në, 09.05.2016.

Sa më sipër, në mbështetje të neneve **517, 518, 525** të Kodit të Procedurës Civile,

LAJMËROJ:

1. Shoqëria "**BIG LIQENI**" Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës, Pallati i ri "FIDAI", Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet Brahillari**, të bëjë ekzekutimin vullnetar brenda **10 (dhjetë)** ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit ndaj palës kreditore **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, duke vepruar sipas:

1. Vendimin Nr. **17**, datë **09.05.2016**, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili vendosi:

- Dënimin e kontrolluesit "Big Market" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
- Dënimin e kontrolluesit "Big Market" Pogradec me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
- Ky vendim u shpall sot në, 09.05.2016.

Sa më sipër, bazuar në Vendimin sipërcituar, debitori, Shoqëria "BIG LIQENI" Sh.p.k., me NIPT **L44213602I**, me adresë në: Lagja Nr. 1, Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës, Pallati i ri "FIDAI", Kati 1, Pogradec; me Përfaqësues Ligjor **Z. Valdet Brahillari**, i detyrohet kreditorit, **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, shumat prej:

- i. **40,000.00 (dyzet mijë)** lekë; dhe
- ii. Tarifën përmbartimore **17,280.00 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë)** lekë (përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) që përfaqëson tarifën për veprime procedurale dhe tarifën bazë, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 1240/5, datë 15.09.2009 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat", pika IX/1).

- Në total detyroheni të paguani shumën **neto** prej **57,280.00 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë)** lekë.

2. Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbartuesi gjyqësor. (shih nenin 517 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile).

3. Nëse ekzekutimi vullnetar nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit, ndaj palës debitore shoqëria "ARB" do të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm.

4. Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i gjobës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.

5. Derdhja e çdo shume të mësipërme **neto** të kryhet detyrimisht pranë **Bankës NBG Albania ("NBG")**, në Numrin e Llogarisë **AL10901110510027173510000017** të **ARB**.

Shoqëria "ARB" Sh.p.k.
Përmbartuesi Gjyqësor Privat
Alban Ruli

Bashkangjitur do të gjeni:

- Titulli Ekzekutiv - Vendimin Administrativ Nr. 17, datë 09.05.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe
- Shkresa Nr. 8352/1 Prot., datë 11.06.2016 "Informacion" të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti Nr. D. 1/399 Nr. 2507.2016 Lck
 Është pranuar në zyrën _____ në drejtim të zotit
shop "BIG LIQENI" shp
 Zyrë No. 1, Rr. 10 Dëshmorët e Kosovës
Prillat. K. "FIDELI", Kati 1, Kogrovac

2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është _____ Dorëzuar më datën _____
 Vëllat Brohollan Paguar
 Emri mbiemri i marrësit të objektit Mel Emri mbiemri i shpërndarësit _____
 SHËNIME TË VEÇANTA _____
 Mula datare e Zyrës _____
 Dorëzuese të objektit _____



POSTA SHQIPTARE sh.a.
Zyra Postare

LAJM R 
RR 153 412 522 AA

Ky lajmerim - marrje do të kthehet
ne adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6

Z. "ARD" shp
 Rr. "Fatmir Hoxhi"
 Pll. 21, shk. 3, Ap. 3,
Tirane

RECEIVED